

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE TREGTETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“PIK AUDIT” SH.P.K.**

Në Tirane sot në date ~~07~~ Korrik 2021 unë shtetasi:

**Mariglen Biti** i biri i Ndrekës, i dtl. 21.04.1975 lindur në Fier dhe banues në Tirane Rr.Ibrahim Kodra Pall. Kristof .Ap.1/1. Madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (kartë identiteti) H50421054M

Kam rënë dakort të themelojme një shoqeri tregtare për të zhvilluar aktivitet tregetar në përputhje me parashikimet e legjislacionit te RSH:

1. Shoqeria është e formës së shoqërive tregtare me pergjegjësi të kufizuar dhe është emërtuar **“Pik Audit” Sh.p.k.**
2. Shoqeria eshte person juridik Shqipetar, i cili do te ushtroje aktivitet privat ne te gjithe territorin e Republikës së Shqiperise pas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit ( QKR ).
3. Shoqeria **Pik Audit Sh.p.k.** zhvillon aktivitetin e saj në perputhje me legjislacionin Shqipëtar dhe me aktet e themelimit të saj (Akt - Themelimi dhe Statuti).
4. Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërise do të jetë:
  - Ndërtimi, operimi dhe shfrytezimi i impianteve të prodhimit të energjise elektrike nga burime të rinovueshme.
  - Ndertimi i objekteve civile dhe industriale.
  - Konsulencë ne te gjitha fushat perfshire ate ligjore, ekonomike dhe tekniko-inxhinierike.
  - Audit të performancës së energjise të ndërtuesave dhe Elementeve të Ndërtuesave.
  - Import eksportin dhe tregtimin e te gjithe mallrave ligjerisht te qarkullueshem ne teritorin e RSH.
  - Ofrimin dhe realizimin e sherbimeve te cdo lloji dhe ne pergjithesi te cdo veprimtarie tjeter te parashikuar dhe lejuar nga legjislacioni i RSH
5. Organet drejtuese modalitetet e krijimit dhe funksionimit te tyre jane percaktuar ne statutin e shoqerise bashkelidhur.
6. Administratori i shoqerise per mandatin e pare emerohet Z.Mariglen Biti ortak i vetem i shoqerise.

Ortaku Themelues  
Mariglen Biti



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Mariglen Biti". Below the signature, the date "07/07/21" is written vertically.

D.t. 07/novrë/2021

## STATUTI I SHOQERISE TREGTETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “PIK AUDIT” SH.P.K.

Shoqeria “Pik Audit ” Sh.p.k. është e krijuar mbi bazën e Akt-Themelimit të shtetasit :

**Mariglen Biti** i biri i Ndrekës, i dtl. 21.04.1975 lindur në Fier dhe banues në Tirane Rr.Ibrahim Kodra Pall. Kristof .Ap.1/1. Madhor dhe me zotësi të plete juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (kartë identiteti) H50421054M për të zhvilluar aktivitet tregetar ne fusha të ndryshme për të cilin është vendosur përpilimi i këtij Statuti si më poshte:

#### Neni 1

#### EMERTIMI

Shoqeria eshte quajtur **“Pik Audit” Sh.p.k** dhe administrator z Mariglen Biti.

Ajo eshte nje person juridik Shqipetar, i cili do të ushtroje aktivitet privat ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise pas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR).

Shoqeria **Pik Audit Sh.p.k.** zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjisacionin Shqipëtar dhe me aktet e themelimit të saj (Akt - Themelimi dhe Statuti).

Ortaku në këtë sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij, me qëllim që të përfitoj të ardhura, që mund të vijne nga ushtrimi i veprimitarise private, si dhe të përballoje humbjet të cilat mund të krijohen.

#### Neni 2

#### OBJEKTI

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërise do të jete:

- Ndërtimi, operimi dhe shfrytëzimi i impianteve të prodhimit të energjise elektrike nga burime të rrinovueshme.
- Ndertimi i objekteve civile dhe industriale.
- Konsulencë dhe supervizim në të gjitha fushat perfshire ate ligjore, ekonomike dhe tekniko-inxhinierike.
- Audit të performancës së energjise të ndërtesave dhe Elementeve të Ndërtesave
- Import eksportin dhe tregtimin e të gjithe mallrave ligjërisht të qarkullueshëm në territorin e RSH.
- Ofrimin dhe realizimin e sherbimeve te cdo lloji dhe ne per gjithesi te cdo veprimitarie tjeter te parashikuar dhe lejuar nga legjisacioni i RSH

**Per realizimin e qellimit te mesiperme shoqeria ka te drejte :**

- Te kryeje punime civile per germime e stemime terrenesh prodhim elementesh te parafabrikuar betoni e b/ armeje, ndertime civile etj.
- Te kryeje punime montimi dhe tekonologjike.
- te perfundoje kontrata me qellim t'ju besoje te treteve pjese te punimeve te siperpermendura.
- te operoje si ne teritorin nacional dhe jashtë dhe te perfundoje operacione importi dhe eksporti;

- Shoqeria mundet gjithashtu te realizoje te gjitha operacionet industriale, tregetare , mobiliare, imobiliare dhe financiare qe do te konsiderohen nga organet e shoqerise te nevojshme ose te dobishme per arritjen e objektivit te shoqerise , ketu perfshihen leshimi i garancive reale ose personale ne favor te te treteve .

### **Neni 3**

#### **SELIA**

Shoqeria “Pik Audit” Sh.p.k. e ka seline e saj në , “Rr. Grigor Heba”, Nd 17, AP 5, H 4, Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tirane. Ajo ka te drejte te krijoje renda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, dege, filiale, agjensi perfaqesi, si dhe ti suprimoje ato.

### **Neni 4**

Shoqeria do te kete nje kohezgjatie te pacaktuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat statutore.

### **Neni 5**

Kapitali fillestar themelor i Shoqerise eshte **100.000 ( njëqind mijë ) leke**.

Kuotat e kapitalit jane te zoteraura ne masën 100 % nga ortaku i vetëm si me poshte:

<b>Emri</b>	<b>Perqindja</b>	<b>kuota</b>	<b>kontributi ne lek</b>
<b>Mariglen Biti</b>	<b>100%</b>	<b>1</b>	<b>1000</b>

Kuotat e kapitali do te shlyhen teresisht ne te holla nga ortaku themelues brenda 30 diteve nga data e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregtar.  
Ne librat e shoqerise do te shenohet kapitali i derdhur.

### **Neni 6**

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve.

Te gjitha pjeset e kapitalit te Shoqerise mund tu kalojne, transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne ortakeri, pasi te jete marre miratimi i ortakeve te tjere ne perputhje me dizpozitat ligjore

Trashegimtari hyn ne Shoqeri me te gjitha te drejtat e ortakut.

### **Neni 7**

Fitimi neto i realizuar nga ushtrimi i veprimitarise ekonomike te Shoqerise do ti shperndahet ortakeve . Asamblea mund te vendose qe pjesa te ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregetar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyej te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve .

### **Neni 8**

#### **ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI NE SHOQERI**

Organet drejtuese te shoqerise jane:  
Asamblea e Pergjithshme

Administratori i shoqerise caktohet Z Mariglen Biti.

Asamblea e per gjithshme thirret per te vendlodur me kerkesen e administratorit  
Ose te cdo ortaku qe perfaqeson jo me pak se 40% te kapitalit.

Ne cdo rast eshte ne juridikcionin e ortakeve :

- 1) Emerimi i administratoreve.
- 2) Miratimi i llogarive dhe shperndarja e fitimit.
- 3) Emerimi ne rastet e parashikuara nga ligji te eksperteve.
- 4) Modifikimi i statutit.
- 5) Vlendimet lidhur me operacionet qe perbejne nje modifikim thelbesor te objektit te aktivitetit.
- 6) Vendime relative:
  - per realizimin e operacioneve qe impenjojne shoqerine per nje vlere rast pas rasti me te madhe se 5.000,00 (pesemije) Euro.
  - rritje ose zvogelje te kapitalit te shoqerise
  - marrjen e kredive.
  - Prishjen e shoqerise
- 7) Cdo ortak ka te drejte te te marre pjesa ne vendimet e ortakeve dhe vota e tij ka vlere ne proporcion me pjesemarrjen e tij ne kapitalin e shoqerise.

### **Neni 9**

Asamblea e per gjithshme mblidhet cdo vit brenda kater muajve, nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te Shoqerise

### **Neni10** **ADMINISTRATORI**

Administratori qendron per nje periudhe 5 (pese) vjecare ne detyre.  
Mandati i tij mund te jete i rinovueshem. Asamblea e per gjithshme gezon te drejten ne cdo kohe te shkarkoje nga detyra administratorin dhe te emeroje nje tjeter ne vend te tij.  
Administratori ka te gjitha kompetencat e administrimite zakonshem te shoqerise per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise , me perjashtim te kompetencave te atribuara vendimarrjes se Asamblese se Pergjithshme te vetem ne kuptim te ligjit dhe te ketij stauti dhe kufizimeve te vendlodura ne aktin e emerimit te tij.

### **Neni 11**

#### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE DHE REZERVA E DOMOSDOSHME**

Cdo vit finanziar fillon me 1 Janar te cdo viti dhe perfundon me 31 Dhjetor, me perjashtim te vitit te pare, ku si fillim eshte data e rregjistrimit te shoqerise.

### **Neni 12**

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret, apo nga ekspertet kontabel miratohen nga Asamblea e

Pergjithshme. Miratimi i dokumentave financiare vjetore behet brenda nje afati 3 - mujor , te mbylljes se vitit finanziar .

#### **Neni 13**

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit, por mund te krijoje edhe fonde te tjera.

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhies se sigurimeve shoqerore, etj Ajo ka te drejte te celi llogari likujduese prane bankave te vendit dhe te kryej veprime likujdimi me to .

#### **Neni 14**

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishies se saj. Per kryerien e ketij procesi emerohen nje ose disa likujdatore te cilet ndjekin operacionet e likujdimit deri ne fund dhe i paraqesin Asamblese se per gjithshme dhe administratorit rezultatet perfundimtare te likujdimit . Ne perfundim Asamblea e per gjithshme vendos per heqien e mandatit te tyre . Per te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga likujdimi, Asamblea e Pergjithshme do te vendose per menyren dhe modalitetet e shlyerjesse tyre.

#### **Neni 15**

Ortaket e Shoqerise mund te beje ndryshime e plotesime ne Statut dhe ne aktin e themelimit pa rene ndesh ne menyre thelbesore ne cdo kohe , me nenet e pershkruara ne kete Statut. Ndryshimet e plotesimet behen ne te njeften menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti

#### **Neni 16**

Ceshtjet e tjera qe nuk jane trajtuar ne kete statut , gjithshka i referohet ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare" si dhe ligji Nr. 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", legjislacionit shqipetar ne fuqi, si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre .

#### **Neni 17**

Ky statut eshte perpiluar dhe firmosur ne kater kopje me vlere te njejte me origjinalin.

**Ortaku Themelues**

**Mariglen Biti**

